
REFERATE E KUMTESA

VALENTINA DUKA**NGA PRESIDENCA NË MONARKI: ÇËSHTJE
TË LEGJITIMITETIT***

Kalimi i Shqipërisë në sistemin monarkik të qeverisjes, në vjeshtë të 1928-ës, ishte në fakt kalim në një sistem më afër tradicionales dhe më të pranueshëm për shqiptarët, se sa sistemi republikan. Mbështetës i kësaj filozofie, Faik Konica, në gusht të 1928, duke lobuar për Zogun mbret në radhët e diasporës shqiptare të Amerikës, shprehej:

“Përgjithësisht, në të tridhjet-e-tre vjet përvojtesh, s’kam hasur pothuajse asnjë i cili të ketë qënë republikan. Për shëmbëll, këtu në Amerikë, në më të shumtat shtëpi që kam vizituar kam parë fytyrën e Prins Wied-it; dhe një bandë muzike, që tani nuk është më, kish emrin “Banda e Mbretëreshës Sofi”. Veçan intelektualët, ose të veqojturit ashtu, më janë çfaqur n’Itali, n’Austri dhe gjetkë, monarqistë të tërbuar. Tregomëni një “intelektual”, dhe jam gati të ju jap emrat e kandidatëve që ay ka përkrahur për fronin e Shqipërisë”... “Sa për mua personalisht, siç kam thënë dhe shkruar shumë herë në kohët e shkuara te “Dielli” dhe gjetkë, jam i mendjes se forma s’ka aqë rëndësi sa njerëzit. Ka republika të liga dhe të mira. Ka monarqi të liga dhe të mira”¹.

Republika Shqiptare, e themeluar prej Zogut në fillim të vitit 1925, ishte pasqyrim i një lëvizjeje të zgjuar të tij, jo vetëm po të mbahet parasysh realiteti politik shqiptar, por edhe rrethanat ndërkombëtare të kohës. Në vitin 1925, kur zotëronte shumicën e pushtetit në Shqipëri, Zogu mund të ishte vetëshpallur me lehtësi mbret dhe ndoshta do të kishte ndërtuar një shtet që në fillim më të qëndrueshëm, por, duke u nisur nga fakti se vendi sapo kishte dalë nga përvoja e një revolucioni të

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare me temë: “Monarkia Shqiptare, 1928-1939”, organizuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 1 shtator 2008.

¹ “Lëvizja monarqike në Shqipëri: një intervistë me z. F. Konitza”, *Dielli*, Boston: 24 gusht 1928, nr. 5000–(793), f.2.

majtë, siç ishte Revolucioni i Qershorit, ai nuk dëshironte t'u jepte shqiptarëve dhe faktorit ndërkombëtar përshtypjen se ishte një konservator i pandryshueshëm që mendonte vetëm për interesin vetjak dhe jo për atë të vendit të tij.²

Por, mendojmë se ka edhe një arsye tjetër të rëndësishme jo shumë e elaboruar nga historiografia shqiptare dhe ajo e huaj, çka e detyroi Zogun që fillimisht të pranonte postin e presidentit të Shqipërisë. Me këtë veprim ai dëshironte t'i hiqte legalisht, çdo mundësi princit shqiptar me origjinë gjermane Vilhelm Vid që asnjëherë nuk kishte abdikuar, të drejtën për t'u rikthyer në fronin mbretëror të Shqipërisë.

Çështja e Vidit ishte një çështje shumë delikate, dhe sipas ministrit amerikan në Tiranë, Hart, Zogu dhe ekipi i tij ishin vazhdimisht të shqetësuar kur ishte fjala për projektin politik të kurorëzimit të Presidentit si mbret i Shqipërisë. Sipas mendimit të specialistëve të së drejtës ndërkombëtare afër Zogut, me shpalljen e Republikës Shqiptare, u suprimua plotësisht forma monarkike e qeverisjes në Shqipëri, që ishte sanksionuar nga Konferenca e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha, e mbledhur në Londër më 1913. Kjo tashmë përbënte një fakt të pranuar nga të gjitha shtetet e mëdha dhe të vogla, të cilat akredituan përfaqësuesit e tyre pranë Presidentit të Shqipërisë. Vendosja e sistemit republikan sipas shtypit pranë Zogut, *jo vetëm që e aboloj sistemin princor shqiptar, por çfarë përbënte rëndësi të madhe, ky abolim u njoft nga e gjith bota duke siguruar de jure e de facto suprimimin e princërisë shqiptare (të Vidit-V.D.).*³ Pavarësisht nga kjo, Zogu në këtë çështje tregoi kujdes të veçantë. Ai i trembej gjetjes së ndonjë hapësire tjetër ligjore nga Fuqitë e Mëdha për rikthimin e Vidit në fronin e Shqipërisë.

Si rrjedhim, lëvizjet e tij për të fituar kurorën mbretërore shqiptare gjatë periudhës së parë të aktivitetit politik në krye të shtetit shqiptar ishin kryesisht të ngadalta dhe shumë të matura. Zogu dhe ndihmësit e tij mendonin se ishte e domosdoshme fillimisht të luftonin për të bindur Fuqitë e Mëdha si dhe për të siguruar mbështetjen e tyre për arritjen e këtij objektivit. *“... ndërrimi i Regjimit është më tepër një çështje që duhet studiue nga pikpamja e marrëdhënieve të jashtme me Shtetet e tjerë,*

² Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: “Çabej”, 2004, f.143.

³ Malo Krimshi, “Monarkia në Shqipëri e pretendimi absurd i Princ Wied-it”, *Gazeta Telegraf*, 30 gusht 1928, nr. 54, f.1.

shkruante gazeta proqeveritare, "Telegraf" më 10 gusht 1928, *se sa nga pikpamja e rregullimit të brendëshme të qeveris.. siç dihet përgjithësisht që në çdo rast të ndrimit të qeverimit, shtetet e tjerë e mbajnë për vete të drejtën më të plotë që t'a njohin ose jo ndryshimin.*"⁴

Fillimisht, Zogu, në shërbim të idesë së tij për t'u bërë mbret i Shqipërisë, siguroi mbështetjen e Italisë, aleatja e tij kryesore ndërkombëtare, si dhe të një pjese të mirë të shtypit italian. Shteti dhe media italiane, luajtën një rol crucial si në bindjen e kancelarive të tjera evropiane ashtu edhe të opinionit publik evropian, të dy këta faktorë shumë të rëndësishëm për t'i dhënë Zogut jo vetëm fronin por edhe jetëgjatësinë e tij. *"Përgatitje të nxehta po bëhen në Tiranë për Asamblenë Konstituante dhe proklamimin e Ahmet Zogut Mbret i Shqipërisë. Gazetat italiane salutojnë simpatikisht ngjarjen se nënë regjimin manatik (monarkik – V.D.) dhe nën udhërimin e A. Zogut, Shqipëria do të arrijë plotësiht bashkimin kombëtar dhe politik dyke çvilluar qytetërimin e saj ca më shumë."* shkruhej në faqet e gazetës "Zëri i Korçës".⁵

Pas Italisë dhe me mbështetjen e saj, Zogu iu drejtua anglezëve, duke dëshmuar me këtë veprim rëndësinë dhe ndikimin e madh që ai i njihte Londrës në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Zogu president u përpoq ta bindte diplomacinë angleze se monarkia ishte e domosdoshme për Shqipërinë, pasi forma republikane e qeverisjes nuk garantonte sigurinë e duhur për një shtet të ri, i cili sapo dilte prej trazirave. Kurora, e cila, sipas stafit të Zogut, do të përbënte një autoritet të përhershëm mbi konfliktet e interesave personale të klaneve politike shqiptare, do të siguronte idenë e vazhdimësisë dhe do të krijonte stabilitetin e përgjithshëm për të cilin kishte aq nevojë Shqipëria. Kjo ide tashmë kishte siguruar një mbështetje relativisht të fuqishme në radhët e elitës politike të kohës, gjë që e venë në dukje edhe diplomatët e huaj në Tiranë. Arsyetime interesante rreth këtij argumenti u shpalosën edhe në një pjesë të mirë të shtypit shqiptar të kohës. *"...forma republikane e qeverimit, shkruante "Telegraf", dolli pas tre vjet provimi, e papajtueshme me nevojat më esenciale politike të vendit, i cili gjendet në një situatë të tillë, të brendëshme dhe të jashtme, sa të ketë nevojë për një*

⁴ "Ndrrimi i regjimit është më tepër një çështje me rëndësi të jashtme se sa të brendëshme", *Telegraf*, Tiranë: 10 gusht 1928, nr. 147, f.1.

⁵ "Shqipëria nënë regjimin monarkik", *Zëri i Korçës*, Korçë: 25 gusht 1928, nr. 322, f.1.

qeveri me autoritet më të madh dhe më të njohur. Partizanët, - midis të cilëve numurohen njerëzit më të shënuar dhe aktive të jetës politike në Shqipëri, - të kësaj ideje që po përhapet me tepër dita me ditën, janë të bindur që Statuti i Republikës i hartuem në kohra anormale, gadi të nesërmen e trazirave dhe përmbysjeve, duhet ndryshuar radikalisht në një mënyrë të tillë që t'i japë Shqipërisë një kryesi të Shtetit më të naltë dhe më të pushtetëshme.”⁶

“Mbreti, shkruante nga ana tjetër gazeta “Kombi”, nuk ka më shumë fuqi se presidenti. Ka mbretër që kanë të njëjtat fuqi sa presidenti dhe ka mbretër që u është kufizuar fuqia. I vetmi ndryshim midis presidencës dhe mbretërisë, është se mbreti zgjidhet përjetë dhe është i trashëgueshëm, kurse presidenti zgjidhet për një kohë të caktuar. Por nëse kjo e fundit është e mundur në republika të përparuara, të cilat kanë shumë njerëz të zotë, kjo nuk vlen për Shqipërinë... Mbretëria krijonte kushtet që të futeshin në punë njerëzit më të zotë, zhduk abuzimet dhe klientelizmat.”⁷

Londra ishte skeptike ndaj arsytetimeve të paraqitura nga ekipi i Zogut lidhur me domosdoshmërinë e vendosjes së monarkisë si garante e vazhdimësisë dhe stabilitetit të Shqipërisë, pasi ajo u trembej bajraktarëve të Veriut, historikisht rebelë e të pabindur, si dhe druhej se mos ndryshimi i formës së qeverisjes mund të shkaktonte shqetësime edhe jashtë kufijve të Shqipërisë.⁸

Por, Zogu i deklaroi Sir Robert Hodgeson-it, në atë kohë ambasador i Britanisë së Madhe në Shqipëri, se ai ishte i bindur se, përveç italianëve që e mirëpritnin këtë ndryshim, dashamirës ndaj këtij plani ishin edhe grekët, me të cilët marrëdhëniet në përgjithësi ishin të mira. Gjithashtu, ai u përpoq të sqaronte diplomatin e lartë të Mbretërisë së Bashkuar se kishte marrë përgjigje neutrale dhe dashamirëse edhe prej pjesës tjetër të Europës.⁹

Megjithatë, më në fund, diplomacia britanike dhe ajo europiane në tërësi, të bindura edhe nga diplomacia italiane, tejet aktive në këtë mes, si dhe të etura për të parë një Ballkan të qëndrueshëm, u pajtuan për t'i hapur dritën e gjelbër ndryshimit të formës së qeverisjes në Shqipëri. “Sa për çështjen e përshtypjes që do të bëjë te shtetet e hueja ndrrimi i

⁶ “Çështja e regjimit po çilet sërish”, *Telegraf*, Tiranë: 5 gusht 1928, nr. 144, f.1.

⁷ “Ndryshime midis Republikës dhe Mbretnis Kostitucionale”, *Kombi*, Tiranë: 19 gusht 1928, f.1-2.

⁸ B.J. Fischer, *vep. e për. m.*, f.147.

⁹ *Po aty*, f.148.

regjimit t'onë, informohet nga burime të sigurta, se është pritur përgjithësisht pa kundërshtim. Bile, disa nga shtetet ma me rëndësi, kanë çfaqur qysh tash pëlqimin e tyre mbi ndërrimin e regjimit” shkruante gazeta “Shekulli i ri”¹⁰.

Nga ana tjetër, fqinja veriore e Shqipërisë, Jugosllavia, e njoftuar me shumë vonesë për veprimin e Zogut, fillimisht refuzoi të jepte pëlqimin duke nënvizuar se ajo priste evolucionin e ngjarjeve¹¹. Gjendja me jugosllavët mbeti përkohësisht e bllokuar në pritje të datës së realizimit të ndryshimit. Por në fund të gushtit 1928, edhe lajmet që vinin nga Jugosllavia për këtë çështje, ishin pozitive. Gazetat jugosllave, i komentonin zhvillimet në Shqipëri me një gjuhë korrekte e, madje edhe pozitive. Një ministër i kabinetit kishte deklaruar se qeveria jugosllave, si gjithë të tjerat, nuk ishte lajmëruar zyrtarisht mbi shpalljen e monarkisë së Shqipërisë, porse qëndrimi i saj nuk do të ishte i ndryshëm nga qeveritë e tjera. I njëjti zyrtar i shtetit fqinj vlerësonte se ndërrimi i formës së qeverisjes në fqinjin jugor ishte një akt që nuk varej prej ndonjë vendi tjetër, përveç Shqipërisë, dhe se nuk duhej parë si sukses i ndonjë personi, por vetëm si zhvillim i këtij shteti të vogël në një formë të caktuar, që sidoqoftë, do t'i garantonte pavarësinë dhe do t'i krijonte kushte edhe për një përparim kulturor dhe ekonomik.”¹²

Edhe pse arriti ta bindë faktorin ndërkombëtar, Zogu e kuptonte se një ndryshim i tillë kushtetues kërkonte domosdoshmërisht përgatitje të shumta edhe në planin e brendshëm. Duke qenë kurdoherë mjaft i kujdesshëm për ruajtjen e formës legale, ai u përpoq që ky ndryshim të bëhej brenda një kuadri kushtetues të rregullt. Meqenëse, juridikisht, Parlamentit nuk i njihej e drejta të ndryshonte Kushtetutën republikane, në muajin qershor, presidenti i bindi deputetët të votonin një ligj organik, me anë të të cilit kërkohej shpërndarja e Parlamentit dhe organizimi i zgjedhjeve të reja në një datë të afërt për krijimin e një Asambleje Kushtetuese me të drejta ligjore për të rishikuar Kushtetutën.

Zogu e ndiente se një vendim unanim i Asamblesë mund të ndikonte pozitivisht te të gjithë ata që ishin ende skeptikë për pritjen që do t'i bënte populli shqiptar shpalljes së monarkisë. Prandaj, në përputhje

¹⁰ “Mbi ndërrimin e regjimit”, “*Shekulli i ri*”, Durrës: 24 gusht 1928, nr. 49, f.4.

¹¹ B.J. Fischer, *vep. e për.*, f.149.

¹² “Komentat e shtypit jugosllav mbi ndërrimin e regjimit në Shqipëri”, *Shekulli i ri*, 31 gusht 1928, nr. 55, f.1.

me planin e tij, bëri të gjitha përpjekjet për të zgjedhur në Asamblenë Kushtetuese mbështetësit e vet.¹³

Si rrjedhim i masave të ndërmarra prej organeve qeveritare, por edhe të mbështetësve që Zogu kishte anekënd Shqipërisë, si zgjedhës të dytë për në Asamblenë Kushtetuese fituan të gjithë kandidatët proqeveritarë.

Pas përfundimit të zgjedhjeve dhe mbledhjes së Asamblesë Kushtetuese, në fund të gushtit 1928, Zogu dhe shumica e këshilltarëve të tij menduan se tashmë puna e tyre kishte mbaruar dhe se nuk mbetej më veçse vendosja ceremoniale e kurorës përpara popullit. Por ministri i Jashtëm Iliaz Vrioni, i cili kuptonte më shumë se të tjerët në lidhje me marrëdhëniet publike dhe diplomacinë, deklaroi se ishte e domosdoshme që ky veprim, para se të ekzekutohej, t'u bëhej i njohur zyrtarisht vendit dhe botës në përgjithësi, nëpërmjet organeve të shtypit shqiptar dhe të huaj.

Përgatitja e opinionit publik shqiptar fillon me vërshimin drejt Tiranës të telegrameve ku kërkohet ndryshimi i formës së qeverisjes dhe zgjedhja mbret e Ahmet Zogut. I pari telegram që mbërrin në Tiranë ishte ai i zgjedhësve të dytë të Skraparit, i dërguar më 17 gusht. Nuk kemi gjetur asnjë dokument që të dëshmojë se ky telegram ishte dërguar me urdhër nga Tirana apo jo. Ndoshta mund të ishte i ndjerë dhe spontan. Por, menjëherë pas dërgimit të telegramit të zgjedhësve të dytë të Skraparit, Ministria e Brendshme, po më 17 gusht 1928, u dërgon një urdhër gjithë prefekturave dhe nënprefekturave të Shqipërisë, ku kërkohet që edhe këto, ashtu siç veprroi Skrapari, të organizonin dërgimin e telegrameve të ngjashme.¹⁴ Pothuajse të gjitha prefekturat dhe nënprefekturat iu përgjigjën pozitivisht këtij urdhri po atë ditë ose më së shumti, të nesërmen.

Pas vërshimit të telegrameve, plani vijon në pjesën e tij pasardhëse, dhe më konkretisht, me organizimin e manifestimeve popullore, ku do të kërkohet ulja e Ahmet Zogut në fronin mbretëror të Shqipërisë. Kështu, në një qarkore të Ministrisë së Brendshme të datës 23 gusht, drejtuar të gjitha prefekturave dhe nënprefekturave, këto të fundit urdhëroheshin që, pas kryerjes së të parit manifestim në Tiranë më 20 gusht, në datën 25 të të njëjtit muaj, të organizonin manifestime të ngjashme në njësitë

¹³ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi 152, viti 1928, dos. 1, fl. 21.

¹⁴ Po aty, fl. 150.

administrative përkatëse. Sipas kësaj qarkoreje, populli duhet të kërkojë ndryshimin e formës së qeverisjes dhe shpalljen e Ahmet Zogut mbret.¹⁵

Mitingje mbështetjeje u organizuan anë e kënd vendit, të mbështetura me logjistikë të fuqishme nga vetë qeveria. Kësaj shtate i bënte jehonë të fuqishme edhe shtypi, i cili raportonte çdo ditë për mitingje të organizuara në të gjitha qytetet e vendit. Në një nga numrat e saj, gazeta “Telegraf” shkruante: *“Një numër i madh mitingjesh po zhvillohen në krejt vendin, të cilat kërkojnë ndërrimin e regjimit dhe shpalljen e A. Zogut mbret. Një miting i tillë i madh u krye në Tiranë, ku veçohet pjesmarrja e nxënësve të shkollave, miting ky që u shoqërua nga banda e ushtrisë (që jo rastësisht është edhe pjesë e organeve shtetërore më besnike ndaj regjimit). Në të foli Xhafer Zelka, drejtor shkolle. Një miting i ngjashëm u zhvillua edhe në Shkodër, në të cilën kanë folur përfaqësues të bashkësisë myslymane dhe asaj katolike. Nga pala myslymane foli Jonus Baliqi dhe nga pala katolike foli Zef Kurti.”*¹⁶ Ndërsa në “Gazetën Shqiptare” nënvizohet pjesëmarrja aktive e femrës shqiptare në manifestime dhe në shfaqjen e entuziazmit për ndërrimin e regjimit dhe kurorëzimin e A. Zogut si mbret. Këtij fakti i jepej rëndësi, sepse deri në atë kohë, në këto vende të Lindjes femra kishte qenë e përjashtuar nga politika. Në këto shfaqje entuziazmi, sipas së njëjtës gazetë, nuk merrnin pjesë vetëm ato femra që kishin pasur mundësi të dalin në Perëndim, që kishin studiuar andej, por të gjitha femrat shqiptare¹⁷. Edhe gazeta “Demokratia” e Gjirokastrës ishte në të njëjtën vijë në këto njoftime kur shkruante: *“Krahinat dhe Bashkit si dhe sgjedhësit e dytë kanë dërguar telegrame, me të cilat, tue marrë para sysh interesat kryesore të Kombit e tue u mbështetur në traditat trashëgimtare të popullit, çfaqin në emër të tij dëshirën për ndrimin e regjimit republikan në atë të monarshisë me mbret Shpëtimtarin e Kombit E. e T. A. Zogun, si shënjë adhurimi për shërbimet e nalta të Tij ndaj Atdheut t'onë të dashur.”*¹⁸

Krahas mitingjeve, ekspertët e fushatës propagandistike të Zogut u kërkuan gjithashtu disa botuesve të shkruanin enkas artikuj për të përpunuar mendjen e lexuesve shqiptarë për këtë ngjarje. *“Këto janë*

¹⁵ *Po aty*, fl. 185.

¹⁶ “Metinge për shpalljen e Monarkisë”, *Telegraf*, Tiranë: 27 gusht 1928, nr. 157, f.1.

¹⁷ Gustavo Traglia, “Shpirti i një populli të ri”, *Gazeta shqiptare*, Bari: 29 gusht 1928, nr. 205, f.1.

¹⁸ *Demokratia*, Gjinokastër: 21 gusht 1928, nr. 168, f.1.

dëshirat e popullit. Dhe përse duhen bërë këto ndryshime, del se regjimi monarqik është shumë m'i mirë e më fitimprurës për vendin t'ënë se ky lidhet me traditat e më historinë t'ënë. Dhe për monarkun e Shqipërisë populli pelqen dhe zgjeth A. Zogun me që ky është Ay që do ta shpjerë anien e shtetit në skelën e përparimit, të mburësisë e të lumturisë kombëtare.” shkruante “Gazeta shqiptare”.¹⁹ “Mitinget, manifestacionet e brohoritë e popullit shqiptar, që po bëhen në çdo kënd të Shqipërisë, kërkojnë prej Asamblesë konstituente, vendosjen më të shpejtë të monarkisë dhe proklamimin e A. Zogut Mbret të Shqipërisë. Asambleja po bombardohet me telegrame dhe nga Shkodra, mi kryeqytetin, po flyturon aeroplani dhe po heth proklama me anën e të cilave, populli, kërkon sa më shpejt vendosjen e Monarkisë me A. Zogun Mbret” shkruante një tjetër gazetë e madhe siç ishte “Gazeta e Korçës”²⁰.

Mjaft interesante, lidhur me përgatitjet për shpalljen e Zogut mbret, janë edhe raportimet që ministri amerikan në Tiranë, Charles Hart, i dërgonte Departamentit të Shtetit. Kështu, në një raport që ai i dërgonte Washington-it më 13 shtator, njoftonte se manifestimet filluan të zhvilloheshin “pas një fushate të dendur të kryer nga gazetatat e Shqipërisë dhe Italisë, për të bërë që të duket se kishte një kërkesë të gjerë publike që kërkonte një ndryshim të formës së qeverisjes.”²¹ *I pari ndër këto manifestime, bënte të ditur Hart, u zhvillua më 20 gusht “kur tellali kaloi përmes rrugëve të Tiranës duke i rënë borisë dhe duke thërritur “Populli ka me m'u mbledhë sot te Xhamia e Et'hem beut!”. ”Të gjitha dyqanet, vazhdon Hart, u lajmëruan të mbyllen dhe të varin ngjyrat (flamujt-V.D.) kombëtare.”²² Ky manifestim, sipas të njëjtit burim, u udhëhoq prej disa hoxhallarëve dhe priftit ortodoks të Tiranës.²³*

Zogu u përpoq gjithashtu që të siguronte edhe mbështetjen publike të trupit diplomatik, duke kërkuar që pjesëtarët e tij të merrnin pjesë në demonstrimet dhe manifestimet popullore që po zhvilloheshin në vend, por diplomatët e huaj, në një mbledhje të organizuar në Tiranë, vendosën

¹⁹ “Duhet mbushur dëshira e popullit”, *Gazeta e Korçës*, Korçë: 31 gusht 1928, nr. 529, f.2.

²⁰ “Populli s'ka durim”, *Gazeta e Korçës*, Korçë: 30 gusht 1928, nr. 533, f.2.

²¹ N. A., 875.01/261.

²² *Po aty.*

²³ *Po aty.*

të mos pranojnë përfshirjen e tyre në të tilla çështje të brendshme të Shqipërisë.²⁴

Kritikët më të rreptë të shpalljes së Zogut mbret ishin kundërshtarët e tij politikë që tashmë ndodheshin në emigracion. Zëdhënësja e tyre kryesore, gazeta “Liria Kombëtare”, që botohej në Gjenevë, vazhdimisht botoi editoriale ku këmbëngulte që të mos ndryshohej sistemi i qeverisjes në Shqipëri. “Mënyrat e përdorura nga autoritetet qeveritare për me e shty popullin e ngratë qi të lypin ndërrimin e regjimit dhe kunorëzimin e Zogut, thuhej në njërin prej shkrimeve të kësaj gazete, kanë qenë fare të trasha dhe qesharake. Zgjedhësit e dytë dhe parësia e vendit janë thirrë natën me gjindarmë nëpër qendrat e gjindarmërive dhe janë detyrue me nëshkrue manifestat telegrafike pa i pyet fare dëshinat e tyre. Me gjithë forcën e madhe qi kanë vue autoritetet e kryeqytetit për me i dhanë gjallmi manifestimeve e mitingëve qi bahen për me lypë ndërrimin e regjimit, prap se prap, ata s’kanë veçse ngjyrën e ceremonive funerale. Sado i paditun, populli i shkretë asht i ndershëm e i squtë dhe di t’i kuptojë se këto komedina tragjike lozen prej Italisë fashiste për me i ba varrin Shqipnis. Por të ban me dal mentsh poshtërsia dhe imoraliteti i intelektualëve qi janë fare pa skrupul dhe me shumë faqe! Për shembëll, i gjithë shtypi shqiptar, deri dje republikan i rreptë, bahet, për një herë, monarkist deri në palcë dhe pa pik turpi, ze më shvillue e me lavdëruë theorinat e idhenat qi deri dje i urrente e i poshtnonte.”²⁵

Ndërsa gazeta tjetër opozitare, “Ora e Maleve”, që botohej në Vjenë, shkruante: “Qi Ahmed Zogu dishron të proklamohet mbret nuk asht një punë e re. Jo vetëm fletoret të cilat me insistencë tash sa kohë persisin lajmin e çuditshëm, por edhe sheje të perparshme e në një mënyrë krejt të veçante, gjesti i tij publik i fundit – propozimi i ndryshimit të shtatutit – na bajnë të kuptojmë se Ahmedi ket herë do t’u vejë kunorë ambicjevet të tia me kunorën e një mbreti në krye. Pompa me të cilën posa hyëni në Tiranë e rrethoj personën e tij, trupi i gardës së veçante, luksi i pallatevet e i vilavet, emisjoni i pullavet postare e i monedhës ar me fëtyren e tij, mosmartesa e tij me të fejuemen, të bijn e Shefqet bej Verlacit, kjene dhe janë sheje të kjarta se presidenti matnjanë po pregatietë rrugen per një shkallë ma t’naltë e më të shkëlqyeshme”.²⁶

²⁴ N.A., 875.01/ 285.

²⁵ “Lajme nga Shqipëria”, *Liria Kombëtare*, Gjenevë: 1 shtator 1928, nr. 90, f. 1-2.

²⁶ “Ahmed Zogu mbret!”, *Ora e Shqipnis*, Vienë: 6 korrik 1928, nr. 8, f.1.

Pas bindjes fillimisht të Italisë për shkak të marrëdhënieve specifike të Zogut me të, bindjes së diplomacisë angleze dhe asaj europiane, pas marrjes së një gjysmëmiratimi nga shtetet e tjera fqinje, përpunimit të opinionit shqiptar dhe europian nëpërmjet shtypit, nuk mbetej gjë tjetër veç përgatitjes me kujdes të bazës ligjore. Për të treguar edhe njëherë se respektonte vendimin e të zgjedhurve të popullit, Zogu u dërgoi të 58 anëtarëve të Asamblesë Kushtetuese një mesazh ku ndër të tjera shkruante: *“Zgjedhsit, në mbledhjen e parë, janë ndaluar të bajnë çdo demonstracion pse, deri sa mbos bahet vertetimi i mandatevet...E vërtetë asht po, qi populli asht i padurueshëm dhe do të thejnë çdo kundërshtim, por me gjith ket, nga pik pamja e proçedurës, tjetër asht me proklamue me vullndetin e plotë të popullit të birin e dejë të Shqipnisë Mbret, tjetër asht me e proklamue në gjithë të një Asamblesë sovranë.”*²⁷

Në ora 16 të datës 30 gusht, u hap Asambleja e cila drejtohej nga Pandeli Evangjeli. I pari që mori fjalën ishte ministri i Mbrojtjes, Abdurrahman Dibra, i cili kërkoi që Asambleja të njihte vullnetin e popullit për shpalljen e Zogut mbret. Më pas fjalën e mori Fejzi Alizoti, i cili kërkoi rishikimin e Kushtetutës. Ndërkohë që zhvilloheshin këto punime, jashtë populli i Tiranës ishte mbledhur në një miting të madh. Në këtë miting kishte veçanërisht shumë gra. Përfaqësueset më të spikatura femra ishin 80 gra dhe 20 vajza të veshura me kostume popullore të qytetit të Tiranës. Ato takuan Zogun në Asamble ku i dhuruan një tufë me lule. Ndërkohë në ajër fluturonin aeroplanë, që hidhnin fletushka ku përshëndesnin shpalljen e Zogut mbret. Po me kostum popullor parakaloi edhe një grup djemsh të kryesuar nga Omer Fortuzi, të cilët morën pjesë në miting me kuaj²⁸.

Ndërsa më 31 gusht 1928, në orën 9 të mëngjesit, Asambleja Kushtetuese miratoi njëzëri dy rezoluta: ndryshimin e tekstit të Kushtetutës, i cili mundësonte kthimin e Shqipërisë në shtet monarkik me sundimtar në vijë trashëgimie dhe, së dyti, dhënien e kurorës mbretërore presidentit Ahmet Zogu me titullin *Zog i I, Mbret i Shqiptarëve*. Komisioni propozoi që me këtë rast të organizoheshin tri ditë festime dhe dita e 1 shtatorit të shpallej festë zyrtare.²⁹

²⁷ G. Traglia, “Shpirti i një populli të ri ...”, *art. i cit.*, f.1.

²⁸ “Fjalimet n’Asamble”, *Gazeta shqiptare*, Bari: 30 gusht 1928, nr. 206, f.1.

²⁹ “Kryesisë s’Asamblesë këtu”, *Shekulli i ri*, Durrës: 1 shtator 1928, nr. 56, f.4.

Në një mënyrë shumë domethënëse për një vend me disa besime, Zogu bëri betimin mbi Bibël dhe Kuran: “Unë, Zogu, mbreti i shqiptarëve, me rastin e marrjes në duart e mia të fuqisë mbretërore, betohem para Zotit të plotfuqishëm se do të ruaj unitetin kombëtar dhe integritetin territorial të shtetit. Unë do t’i përmbahem me besnikëri Kushtetutës dhe do të veproj në bazë të akteve të saj dhe ligjeve në fuqi, duke mbajtur gjithnjë parasysh vullnetin e popullit”.³⁰

Shpallja nga Asambleja Kushtetuese e Zogut si mbret të shqiptarëve dhe jo mbret të Shqipërisë, shkaktoi tërmet në trupin diplomatik në Tiranë. Me anë të një telegrami drejtuar Sekretarit Amerikan të Shtetit Kellog, më 1 shtator 1928, ministri amerikan në Shqipëri shprehej se ndryshimi i formës së qeverisjes ishte bërë në mënyrë të rregullt dhe se do të pranohej prej shqiptarëve, mirëpo, sipas tij, një pjesë e trupit diplomatik në Tiranë duke përfshirë përfaqësuesit francez, jugosllav, turk, gjerman dhe anglez, ishin të shqetësuar jo për legjitimitetin e procesit, sepse gjithçka kishte shkuar si duhet, por për titullin që mori mbreti Zog si *mbret i shqiptarëve*. Gjithashtu diplomati i lartë amerikan theksonte në të njëjtin telegram se ishte informuar në mënyrë shumë konfidenciale që prapa këtij përcaktimi të titullit mbretëror qëndronte qeveria italiane, e cila nëpërmjet Fejzi Alizotit dhe Shefqet Vërlacit i kishte ushtruar presion Zogut një ditë përpara, pra më 30 gusht, për të këmbëngulur në titullin *Mbret i Shqiptarëve*. Vërlaci dhe Alizoti kishin shkuar në pallatin presidencial, ku i kishin deklaruar prerazi Zogut se ata do të jepnin dorëheqjen në qoftë se ai nuk do ta bënte një gjë të tillë.³¹

Jugosllavët, të cilët në përbërje të shtetit të tyre kishin një numër të madh shqiptarësh, e interpretuan këtë si shenjë të një fushate të ardhshme irredentiste kundër vendit të tyre. Zogu u përpoq t’i bindte ata se ai, pavarësisht nga titulli që do të mbante si *mbret i shqiptarëve*, nuk do të nxiste kurrësi lëvizjen irredentiste të shqiptarëve të Kosovës.

Menjëherë pas shpalljes së Zogut Mbret, Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Iliaz Vrioni, u dërgoi një telegram qeverive të vendeve të tjera ku kërkonte njohjen prej tyre të Mbretërisë Shqiptare. Shtetet e para të cilat njohën Mbretërinë Shqiptare ishin Italia si aleatja kryesore e Shqipërisë, fqinji jugor i Shqipërisë Greqia, me të cilën Zogu momentalisht kishte marrëdhënie të mira, si dhe aleatja e shqiptarëve,

³⁰ B.J. Fischer, *vep. e përm.*, f.156.

³¹ *Po aty.*

Hungaria. Por asnjë nga këto shtete nuk luajti rolin e manjetit për të tërhequr shtete të tjera në drejtim të njohjes së Mbretërisë Shqiptare.

Në të vërtetë, pas njohjes nga Italia, Greqia dhe Hungaria, Tirana zyrtare kaloi një periudhë disaditore të heshtjes së plotë diplomatike. Ende nuk po dukej në horizont tjetër shtet që të njëjtte monarkinë, çka shkaktoi nervozizëm dhe stres në pallat. Qetësinë e prishi presidenti amerikan, Coolidge me telegramin e tij entuziazmues dërguar Zogut më 13 shtator 1928, në të cilin ndër të tjera thuhet: *“Është kënaqësia ime t’i shpreh Shkëlqesisë suaj dhe popullit të Shqipërisë përgëzimet me rastin e hipjes suaj në fron. Populli amerikan bashkohet me mua në shprehjen e urimeve më të mira për Shkëlqesinë tuaj shëndet të mirë për lumturi dhe prosperitet për Shqipërinë”*.³²

Në orën 4 të pasdites të datës 14 shtator, ministri i Jashtëm Iliaz Vrioni, shkoi në ambasadën amerikane duke i treguar ministrit Hart telegramin origjinal që presidenti i ShBA-ve i kishte dërguar Mbretit Zog. Sipas Hartit, Zogu dhe bashkëpunëtorët e tij ndjeheshin mjaft të lumtur, sepse, sipas tyre, kur të njeh qeveria më e fuqishme e botës edhe shtetet e tjera do të ndiqnin shembullin e saj. Pikërisht ashtu siç mendohej ndodhi. Jugosllavia e njohu Mbretërinë Shqiptare po atë ditë. Ndërsa Britania e Madhe dhe Franca e njohën atë më 21 shtator 1928, pa ngritur asnjë pretendim për titullin e mbretit shqiptar.³³

Në shenjë mirënjohjeje, më 15 shtator, ditë kur në qytet bisedohej vetëm për këtë ngjarje, u organizua përpara ambasadës amerikane në Tiranë një miting i madh me rreth 1500 pjesëmarrës, të kryesuar nga banda e qytetit. Në miting u lexua telegrami i presidentit amerikan. Ky tubim u përshëndet nga ambasadori amerikan në Tiranë, si dhe Koço Kota në emër të qeverisë shqiptare.³⁴

Pas ceremonive të shpalljes të tij Mbret i shqiptarëve, Ahmet Zogu filloi të mendonte për vendosjen në një moment të përshtatshëm, në një kohë jo shumë të largët dhe në një vend historik, të kurorës mbretërore. Për këtë eveniment nga më të rëndësishmit e ceremonive pas betimit, Zogu vendosi të kurorëzohej si Mbret i shqiptarëve në prill të 1929-ës, pikërisht në kështjellën e Krujës, për t’u treguar shqiptarëve se tashmë kishte lindur një Skënderbe i kohëve moderne.

³² *Po aty*, f. 850.

³³ *Po aty*.

³⁴ *Po aty*.

Zogu vendosi jo vetëm të kurorëzohej në Krujë, por edhe që në ditën e ceremonialit të mbante përkrenaren origjinale të Skënderbeut e cila në atë kohë ndodhej në Muzeun Kombëtar të Austrisë. Për këtë qëllim, qeveria shqiptare, si negociator të saj me qeverinë e Austrisë, caktoi ministrin e Financave të asaj kohe, Tef Curanin. Ai u dërgua në Vjenë me misionin e posaçëm që, në emër të qeverisë shqiptare, t'i kërkonte qeverisë austriake dorëzimin e përkrenares së Skënderbeut popullit shqiptar të cilit edhe i përkiste kjo vepër muzeale.

Gjithashtu, në këto rrethana, qeveria shqiptare u drejtoi një lutje të gjitha shteteve europiane, nënshkruese të traktatit të Versajës, për ta lejuar qeverinë austriake t'i dorëzonte qeverisë shqiptare përkrenaren e Skënderbeut. Qeveria austriake nuk pranoi asnjë nga ofertat e paraqitura nga pala shqiptare. Zogu afroi edhe një shumë të madhe për ta blerë atë, por edhe kjo mënyrë nuk rezultoi e suksesshme.

Si rrjedhim, Mbretëria Shqiptare nuk arriti të sillte në Shqipëri simbolet e Skënderbeut nga Vjena dhe ndoshta për këtë arsye, Zogu nuk mundi të vinte kurorën e mbretit ashtu siç ai e kishte menduar.

